



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planuar / Doretuar Planned / Produced Received / Delivered	10 - 10	2	viti god year
Organ / Bënda Org / Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kufizimi Quantity
SKPMSTICK	6048/2022		116



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.789/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.789/2021 të datës 08.09.2021, sipas Aktgjykimit Anr. 2756/2021 të datës 28.07.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, të pranuar me date 09.09.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.10.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.789/2021 e datës 08.09.2021 e parashtruar nga ankuesi

II.MBETET në fuqi Vendimi KA.nr.36/2021 me numër të protokollit 09/1353 të datës 06.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 26.04.2021 ka shpallur konkursin e jashtëm për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative", për Gjykatën Themelore në Ferizaj, (një pozite) me numër referencës Nr.02/2021, kodi TIK/470 me koeficientin 7, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, dhe ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit në testin me shkrim dhe me gojë.

Me datë 17.06.2021 është publikuar njoftimi për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, kundër të cilit njoftim ankuesi me datë 16.07.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i cili me datës 06.08.2022 ka nxjerrë Vendimin KA.nr.36/2021 me numër të protokollit

09/1353 me të cilin i është refuzuar ankesa e ankuesit si e pa bazuar, duke lënë në fuqi njoftimin e datës 17.06.2021 për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit, në pozitë "Zyrtar i Teknologjisë Informative", për Gjykatën Themelore në Ferizaj .

Ankuesi kundër Vendimi KA.nr.36/2021 me numër të protokollit 09/1353 të datës 06.08.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka parashtruar ankesë me datë 08.09.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër protokollit 4541/2021, me pretendime ankimore se procedura nuk është zhvilluar konform ligjit dhe rregullores së rekrutimit në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ankesën e ankuesit e ka proceduar me datë 13.09.2021 për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës-SKGJK, më datë 21.09.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar 4741/2021 me shkresat e bashkëngjitura të lëndës nga 1/107 faqe.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje përmes shkresës me numër protokollit 789/2021 të datës 22.10.2021 njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.2756/2021 të datës 28.07.2021 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, tani ankuesit, dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr. 789/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin A.nr. 2756/2021 i datës 28.07.2022 nga Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, Ankesa me numër të protokollit 4541/2021 e datës 08.09.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postës së Kosovës me datën 06.09.2021, nr. R6378724; Vendim i Komisionit për Zgjedhjen e kontesteve dhe ankesave me nr. Prot. 09/1353 i datës 06.08.2021; Dërgesë nga Posta e Kosovës e datës 06.08.2021; Ankesa e ankuesit drejtuar Komisionit të Ankesave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës i datës 15.07.2021 i protokolluar nr. 09/1353 me datë 16.07.2021; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare me numër protokollit 1124 i datës 17.06.2021; Lista e Kandidatëve që kanë kaluar testin me shkrim e datës 10.06.2021, Shpallja e konkursit të jashtëm i datës 26.04.2021, me nr. 01/2021 dhe i datës 01.02.2019; Lista e ngushtë e datës 14.02.2021; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Renditja përfundimtare e kandidatëve me nr. Ref 09/2018, Pliko Postare e datës 06.09.2021; Përgjigje në Ankesë e datës 21.09.2021, nr.protokollit 4714/21; Aplikacioni për punësim i ankuesit i datës 07.05.2021, me nr.Prot. 1130, Diploma e datës 24.06.2010 lëshuar nga Universiteti i Evropës Juglindore-Tetovë, Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjisë Informative, Dega e Shkencave Kompjuterike; Certifikatë e datës 31.01.2020; Certifikatë e datës 18.04.2017; Pasqyra e llogarisë nga Trusti i nxjerr për datën 01.08.2002-29.04.2021; Kontratë e punës e datës 22.05.2020 me nr. 596; Vendim nr.641 i datës 07.05.2021; Referencë e datës 31.12.2019; Referencë e vitit 2015; Rekomandim i datës 06.05.2021; Reference

nr.640 e datës 06.06.2021; Referencë e vitit 2015; Vlerësimi-Testi me shkrim i konkursit të jashtëm nr.02/2021 i datës 04.06.2021, prej 1/5 faqe; Testi me shkrim i ankuesit prej 1/14 faqe; Njoftim për përzgjedhjen përfundimtare i datës 17.06.2021, nr. Prot. 1124; Deklarata të datës 01.06.2021 prej ¼ faqe; Përcaktimi i kriterëve për testin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës, për të cilën nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testi me gojë i datës 11.06.2021; Vlerësimi i testit me shkrim dhe me gojë për kandidatin prej 1/5 faqe; Testi me shkrim, prej 1/14 faqe; Aplikacioni i kandidatit i datës 06.05.2021 me nr. Prot 1098 prej ¼ faqe; Dëftesë e shkollës së mesme "Xhevdet Doda" e datës 25.05.2011 prej 1/3 faqe; Certifikatë e datës 09.06.2020; Vërtetim i datës 15.02.2021; Vërtetim i Punës i datës 31.11.2018; Referencë nga Policia e Kosovës lëshuar nga Referencë nga Posta dhe Telefoni i Kosovës-Ferizaj; Letër motivuese nga ankuesi; Vërtetim Kopje nga Originali i noterizuar nga Noteri Ferizaj me nr. LRP. Nr.5812/2016, Diplomë me nr.021, Fakulteti i Shkencave Kompjuterike me Matematikë të Aplikuar, e lëshuar nga Kolegji Vizioni për Arsim.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se procedura e zhvilluar e rekrutimit për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative", nga Sekretariati i Këshillit Gjykatën të Kosovës, është zhvilluar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi duke theksuar se është zhvilluar me parregullsi si dhe përzgjedhja nuk është bërë në bazë të meritës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konsiston se në konkursin e shpallur të datës 26.04.2021 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative", në Gjykatën Themelore në Ferizaj, kriteret e konkursit kanë qenë:

• **Diplomë universitare në shkenca kompjuterikë- e nevojshme, si dhe me përvojë relevante një (1) vjeçare- e nevojshme.**

Pas shqyrtimit të të gjitha provave të lëndës lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit dhe kriterëve të konkursit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, poentimin e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë ku përcaktohet se: "Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës",.... secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura të tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes", andaj në rastin konkret Kolegji konstaton se në listën e ngushtë është përfshirë ankuesi dhe kandidati i përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm të datës 17.06.2021 për



pozitën "Zyrtar i Teknologjisë Informative", në Gjykatën Themelore në Ferizaj, i cili pretendon se kandidati i përzgjedhur nuk e ka kualifikimin dhe përvojën nga fusha që është kërkuar në konkurs gjegjesisht në fushën e teknologjisë informative.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit që lidhet me kualifikimin profesional dhe përvojën e punës të kandidatit të përzgjedhur për pozitën "Zyrtar i Teknologjisë Informative", në Gjykatën Themelore në Ferizaj, janë të pa qëndrueshme sepse kandidati i përzgjedhur posedon Diplomë Universitare me numër 021, të lëshuar në muajin dhjetor 2015 nga Kolegji „Vizioni për Arsim” në Ferizaj, me të cilën dëshmon se ka përfunduar Fakultetin e Shkencave Kompjuterike me Matematikë të Aplikuar, në programin studimor Shkenca Kompjuterike me Matematikë të Aplikuar me datë 02.12.2015, ku ka marr titullin Bachelor i Shkencave Kompjuterike, si dhe me përvojë pune si në vijim: prej datës 01.11.2014 deri me datë 31.11.2018 në pozitën „ IT Administrator” në kompaninë „Eorld Communications L.L.C” në Prishtinë; prej datës 01.11.2018 deri me datë 31.07.2019 në pozitë „ Teknologji Informative-IT” në Kompaninë në Ferizaj, dhe se kandidati i përzgjedhur i ka plotësuar kriteret e përcaktuara sipas konkursit të datës 26.04.2021, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vendin e punës "Zyrtar i Teknologjisë Informative", në Gjykatën Themelore në Ferizaj, të cilat kanë qenë: *Diplomë universitare në shkenca kompjuterikë- e nevojshme, si dhe me përvojë relevante një (1) vjeçare- e nevojshme.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitura në dosjen e kandidatit të përzgjedhur dhe të ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka vlerësuar drejtë me rastin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatit të suksesshëm për pozitën "Zyrtar i Teknologjisë Informative", në Gjykatën Themelore në Ferizaj, duke u bazuar në nenin 2 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se: *"Merita-veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes"*, sepse kandidati i përzgjedhur i ka përmbushur kriteret e veçanta dhe të përgjithshme të kërkuara në konkursin e shpallur me datë 26.04.2021, për pozitën "Zyrtar i Teknologjisë Informative", në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen përfundimtare, ka vepruar drejtë duke bërë vlerësimet e testit me shkrim dhe me gojë si për ankuesin, po ashtu edhe për kandidatin e përzgjedhur duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe në bazë të vlerësimeve kandidati i përzgjedhur ka arritë gjithsejtë 326 pikë nga pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesi ka arritur gjithsejtë 296.25 pikë të përgjithshme nga testit me shkrim dhe testit me gojë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se përzgjedhja e kandidatit është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe*

me gojë”, “Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pakë se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara”, në rastin konkret konkursi është shpallur për një (1) pozitë në Gjykatën Themelore në Ferizaj dhe ankuesi pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka arritë gjithsejtë 296.25 pikët e përgjithshme, dhe është renditur i dyti (2) në listën e kandidatëve.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, me datë 17.06.2021 ka publikuar njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare nga procedura e rekrutimit, gjegjësisht ka njoftuar për kandidatin e suksesshëm, duke vepruar në pajtim me nenin 41 paragrafin 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ashtu siç theksohet se : *“Institucioni përkatës është përgjegjës për shpalljen e rezultateve të procedurës së rekrutimit në faqe të internetit të institucionit. Njoftimi përmban emrat e kandidatëve të suksesshëm, vendin e punësimit dhe pikët e fituara gjatë procedurës së përgjithshme”,* andaj mbi këtë baze Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me pa rregullsitë e zhvilluara në këtë procedurë të rekrutimit, janë të paqëndrueshme.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga ankuesi, si dhe organi i punësimit ka konstatuar që procedura e rekrutimit për pozitën *“Zyrtar i Teknologjisë Informative”*, në Gjykatën Themelore në Ferizaj, të shpallur me datë 26.04.2021 nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që nga shpallja publike e konkursit më datën 26.04.2021 e deri në shpalljen për publikimin e rezultateve të procedurës së rekrutimit ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton që: *„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”* dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton që: *„Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”,* si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësorë të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit KA.nr.36/2021 me numër të protokollit 09/1353 të datës 06.08.2021, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave dhe të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Kolegji i Këshillit pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.789/2021

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.